



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Opština Klokot/Komuna e Klllokot**

Datë: 28.06.2019.

Në bazë të nenit 43.(43.1.;43.2.;43.3.;43.4.43.5.) Ligjit për VETQEVERISJE Lokale 03/L-040,si dhe Statutit të komunës sipas nenit 18,është mbajtur seanca e gjashtë e rregullt e Kuvendit komunal të Klllokotit,me rendin e ditës të përgaditur. Me atë rast është hartuar si vijon:

PROCESVERBALI NGA SEANCA E GJASHTË E RREGULLT I KUVENDIT KOMUNAL KLLOKOT NË VITIN 2019

Kryesuesi I Kuvendit : Mirë dita të gjithëve,po e hapim seancën e gjashtë të rregullt të kuvendit komunal Klllokot-Vërbovc,para se të fillojmë kërkoj falje për pak vonesë të arsyeshme në mënyrë që të vijmë të gjithë delegatët në seancën e kuvendit,të tjerët do të vijmë ndoshta do të vonohen pak.

Dëshiroj të përshëndes të gjithë të delegatët e pranishëm,përfaqësuesit e OSBE-së,drejtorët prezent,nënkryetaren për komunitete dhe qytetarët prezent.

Para se të fillojmë me punën e kuvendit duhet të bëj thirrjen e delegatëve në mënyrë që të konstatoj kuorum ;

Hidajet Ahmeti,Ivana Svilanovic,Ognjen Krcmarevic,Igor Petkovic,Velibor Kostic,Milorad Mirkovic,Vesna Przic,Tijana Vujic,Strahinja Spasic,Naser Shabani,Nijazi Fejza,Slobodan Stoilkovic,Shqiprim Rexhepi dhe Afize Rexhepi.

Pasi që bëra thirrjen konstatoj kuorum për mbajtjen e seancës së Kuvendit. Të nderuar delegatë,e keni marrë rendin e ditës I cili përbëhet prej 8 pikave. A dëshiron ndokush të ndyshim apo plotësim të rendit të ditës? Pasi që askush nuk dëshiron ,tani po e jap në votim rendin e ditës së sotme. Kush është për aprovimin e rendit të ditës së sotme?

Faleminderit konstatoj që njëzërit e aprovuam rendin e ditës sotme.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës e ajo është aprovimi i procesverbalit nga seanca e pestë e rregullt e kuvendit për vitin 2019. A dëshiron dikush të thotë dicka lidhur me procesverbalin? Pasi që po e shoh se askush nuk dëshiron,atëherë po e jap në votim ,kush është për aprovimin e pikës së parë të rendit të ditës? 8 votuan Për,aprovimin e pikës së parë konstatoj se të tjerët nuk u deklaruan.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës e ajo është; shqyrtimi dhe aprovimi I propozim vendimit lidhur me planin aksionar për transparencë dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e planifikimit,dhe hartimit të buxhetit komunal për vitin 2020.

A dëshiron ndokush të marr fjalën ? pasi po e shof që askush nuk dëshiron atëherë kalojmë në pikën e dytë. Kush është për aprovimin e pikës së dytë? 8 ishin Për,kundër nuk kishte,abstenime jo. Konstatoj që e kemi aprovuar pikën e dytë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës e ajo është vendosja dhe aprovimi I propozim vendimit lidhur me kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2020-2022.

Urdhëroni zotëri Kelmend Rexhepi .

Kelmend Rexhepi: Përshëndes kryesuesin,nënkryetarën për komunitete dhe të gjithë të pranishmit. Korniza afatmjesme buxhetore është një dokument strategjik nga viti 2020 deri në vitin 2022 e cila në vete përmban projektet e planifiuara. Sigurisht që edhe ju mund të shtoni propozime të cilat nuk I kemi future këtu. Tani që të mos hyj me numra pasi që të gjithë e keni materijalin para jush ,dhe nga Ju kërkoj që këtë pikë ta aprovoni sot.

Kryesuesi i Kuvendit:Urdhëroni zotëri Shqiprim.

Shqiprim rexhepi: Përshëndes të gjithë të pranishmit,po I shof këto projekte tani po flas për fshatin Mogillë,po e shof që disa projekte do të realizohen vitin e ardhshëm. Sa I përket këtyre projekteve cdo gjë është në rregull por unë vetëm dua të jap një propozim për një projekt të vogël,e ajo është rrjetëzimi I ujësjellësit nëpër shkollë,është fjala për ujë të pijshëm pasi që nuk ka ujë të pijshëm në shkollë,kaq.

Kryesuesi i Kuvendit: Të nderuar delegatë e ndëgjuat fjalimin e zotëri Rexhepit dhe zotëri Kelmendit. Kush është për aprovimin me këtë ndryshim dhe plotësim të zotëri Shqiprim Rexhepit për atë që e tha?

8 Për,kundër nuk kishte,tre nuk u deklaruan. Konstatoj që me 8 vota për e aprovuam pikën e tretë të rendit të ditës.

Të nderuar delegatë kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës e ajo është propozimi I dhënjes së pëlqimit nga kuvendi komunal për zbatimin e procedurave ligjore për ndrrimin e destinacionit të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore në ngastrën nr..... Në emër të pronarit Agron Qerimi zona kadastrale Kllokot. A dëshiron dikush të thot dicka apo ta jap në votim? Urdhëroni ja këtu prezent e kemi drejtoreshën e bujqësisë që do të na thot dicka më shumë lidhur me këtë pikë.

Drejtoresha e Bujqësisë,Doruntina Rexhepi, përshëndetje për të gjithë të pranishmit,unë si drejtoresh dua sot këto ti paraqes dy kërkesa nga ana e dy qytetarëve të cilët kanë sjellë kërkesë tek ne dhe sigurisht që ata me kërkesë kanë sjellë komplet dokumentat e nevojshme,tani un nga Ju kërkoj që ta aprovoni këtë pikë,Ju faleminderit.

Kryesuesi I Kuvendit: Falemnderoj drejtoreshën e bujqësisë. A dëshiron dikush të thot dicka? Urdhëroni zonja Selvie Rexhepi.

Selvie Rexhepi: Përshëndes kryesuesin e kuvendit dhe sigurisht të gjithë të pranishmit në sallë. Unë e përkrah drejtoreshën e bujqësisë por vetëm dua të them që këtu sigurisht është bërë një gabim teknik

sepse pikën e tretë e kemi aprovuar si propozim vendim ndërsa tani po flasim rreth pikës së katërt. Sigurisht që ka ndodhur ndonjë gabim teknik lidhur me pikën e katërt dhe të pestë.

Kryesuesi i Kuvendit: Në rregull kuptohet kjo nuk ka asnjë problem, a dëshiron dikush të thotë dicka apo ta hedhë në votim këtë pikë e katërt të rendit të ditës? Kush është për aprovimin e destinimit të tokës?

8 PËR, kundër nuk kishte, tre nuk u deklaruan, konstatoj që me 8 vota për kemi aprovuar pikën e katërt të rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës, kjo është pikë e njejtë propozim vendimin për dhënien e pëlqimit të kuvendit komunal për zbatimin e procedurës mbi ndrrimin e destinacionit të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore në ngastrën nr..... në emër të pronarit Mustaf Hasani zona katastrale Klllokot. A dëshiron dikush të thotë dicka apo ta hedhë në votim këtë pikë? Kush është për aprovimin e kësaj pike? 8 PËR, kundër nuk pati. Konstatoj që me 8 vota për kemi aprovuar pikën e pestë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës e ajo është shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit të kuvendit mbi lejimin e mjeteve financiare mbi pagesën e faturës nr..... për transportuesin NTP Vitia trans nga Vërbai komuna e Vitisë, kjo është që kemi qenë vitin e kaluar në ekskurzion. Naseri dhe Nijaziu janë në dijeni për këtë po ashtu edhe Hidajeti. Kush është për aprovimin e kësaj pike? Kërkoj falje zotëri Hidajet e keni fjalën.

Hidajet Ahmeti: Përshëndes kryesuesin e kuvendit, nënkryetaren për komunitete, drejtorët dhe delegatë. Është e vërtetë që kemi qenë në një vizitë vitin e kaluar por unë mendoj që kjo ka qenë dashur të jetë e planifikuar në kuadër të kategorive ekonomike e jo që të vijë këtu në kuvend si pikë e rendit të ditës që të aprovohet për pagesën e faturës, sigurisht që këtu kemi ekonomista financiar të cilët i njohin këto gjëra, unë personalisht nuk jam që kjo pikë të aprovohet në kuvend sepse mundet në ndonjë mënyrë tjetër të bëhet pagesa.

Kryesuesi i Kuvendit: Jo kjo është lejimi i pagesës, ne e vërtetojmë që kemi qenë dhe që në mënyrë legale ti paguhet njeriut i cili na ka vozitur sepse nesër dikush mund të thotë se nuk ka patur asnjë leje për ti bërë pagesën. Unë mendoj që kjo është në rregull dhe kërkoj që të aprovohet dhe shpresoj që edhe këtë vit me marrëveshje do të shkohet përsëri, do ta shofim me shefin e financave sa mund të ndaj mjete që të shkojmë pak në Durrës. Unë mendoj se pak jemi vonuar me këtë pagesë, nuk është njerëzore ndaj atij personi. Kush është për aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës? 8 PËR, kundër nuk ka, konstatoj që pikën e gjashtë të rendit të ditës e aprova me 8 vota PËR.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës e ajo është shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit të kuvendit mbi lejimin e mjeteve financiare mbi pagesën e faturës për firmën FOTO RINIA nga Vitia.

Kelmend Rexhepi: Lidhje me këtë pikë arsyeja është se vitin e kaluar nuk kemi patur marrëveshje me ndonjë firmë për blerjen e tonerëve dhe letrave për printim. Deri sa jemi konsultuar me agjensionin për tendere, deri sa ata na kanë dhënë dritën e gjelbër ne na është dashur të bashkëpunojmë me Foto Rininë nga Vitia sigurisht që ne kemi kërkuar nga kjo kompani të na furnizoj me material hargjues.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka dikush për të thënë dicka, urdhëro Hidajet.

Hidajet Ahmeti: A është I centralizuar ky rast apo jo?

Kelmend Rexhepi: Kjo ka qenë e planifikuar në prokurim sigurisht që kemi bërë pagesën edhe për këtë edhe për naftën. Ne kemi kërkuar sqarime nga ana e agjensionit për tendera, do të thotë deri sa ata nuk na kanë dhënë përgjigje ne është dashur që dikun të porosisim material dhe sigurisht që kemi arritur marrëveshje me një firmë tjetër deri sa ata nga agjencioni na kanë dhënë përgjigje.

Hidajet Ahmeti: Mënyra se si ju i keni marrë ato kjo të jep mundësinë e manipulimit, unë nuk e di saktë çështjen por e di që disa shërbime janë të centralizuara ndoshta po gabojmë për derivatet e naftës të cilat janë centralizuar do të thotë kjo mënyrë nuk mundet të shkojë kështu kjo është e mirë për vitin e ardhëm në ndonjë pikë të mos gabojmë që të mos ketë dyshime, kaq.

Kryesuesi i Kuvendit: Të nderuar delegatë unë mendoj që Hidajeti e ka më të drejtë dhe se kjo duhet të përkrahet në të ardhmën do të shohim se si duhet të shkojë kjo gjë, nuk e di se si rregullohen këto gjëra në prokurim por në ndonjë seancë tjetër për këtë pak më gjerësisht do ta sqarojmë me zotëri Hidajetin.

Kush është për aprovimin e pikës së shtatë ? 8 Për, kundër nuk pati. Konstatohet që pikën e shtatë të rendit të ditës aprovuam, tani kalojmë në pikën e tetë e ajo është të ndryshme. Urdhëroni të nderuar delegatë a dëshiron dikush të thotë dicka?

Delegati Shqiprim Rexhepi: Dua të shtoj edhe dicka lidhur me pikën të ndryshme, dua të propozoj që procesverbalin ta marrim një javë pas mbajtjes së kuvendit nëse ekziston mundësia ta marrim më herët e pastaj më vonë materialin tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Secili nga delegatë që ka e-mail ta lërë në kuvend dhe kur të përfundohet procesverbali atëherë do t'ua përcjellim. Zotëri Shqiprim ka ndodhur që ndonjëherë procesverbalet janë vonuar për shkak të ngarkesës së madhe të punëve sepse tani shumica janë në pushime vjetore dhe nuk mund të përfundohen procesverbalet në sërbishtë pastaj përkthimi prandaj për këtë arsye ndonjëherë zgjatet që procesverbali të aprovohet në seancën e radhës.

Hidajet Ahmeti: Vetëm dua të jep informuar nëse ka dicka lidhur me objektin e ri, sepse me sa jam i informuar nga ana e operatorit të ndërtesës është përfunduar dhe çdo gjë është në rregull. Tani ka mbetur vetëm të komuna të zbatojë procedurën formale.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa ekziston, shumë herë është kërkuar që të bëhet kyqja e energjisë nga ana e KEDS-it dhe ata deri më sot nuk kanë ardhur, kjo gjë është bërë përmes e-mailit.

Hidajet Ahmeti: Dhe sa i përket procesverbalit unë disa herë kam propozuar që të shënohen emrat e delegatëve kush ka votuar PËR, kush Kundër dhe kush ka abstenuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Të ju them diçka në procesverbal mund të shkruhet sa kanë votuar sikur tani 8 apo 3 kundër dhe të përmbajtur, nëse shkruhen emrat e secilit kjo është procedurë e gjatë, do të thotë kaq ishin për, kaq kundër kaq abstenime që të jemi të sigurt.

Hidajet Ahmeti: Këtë formë e praktikojnë të gjitha komunar sepse është mirë që të shkruhen emrat, pastaj kjo futet në arkivë që të ruhet dhe pastaj pas 10 apo 20 viteve dhe që kur dikush e kërkon procesverbalin e din se cili delegate ka qenë PËR e cili Kundër.

Kryesuesi i Kuvendit: Po me të drejtë e ke. Urdhëroni zotëri.

Delegati Naser Shabani : Përshëndes të gjithë të pranishmit, të njejtën kërkesë e kam edhe unë sikurse edhe zotëriu Hidajet Ahmeti lidhje me objektin e ri të komunës sepse atje kushtet janë më të mira, dhe këtu nuk i kemi ato kushte. E kam një kërkesë nga ana e qytetarëve të Klllokotit, nga ana e komunës kanë dalur në teren do të thotë tek rruga e Zhtisë tek shqiptarët, ata e kishin një ankesë sa i përket matjes së rrugës.

Kryesuesi i Kuvendit: çka ashtu?

Delegati Naser Shabani: Ata janë ankuar sikur dikush atyre u ka thënë që qytetarët duhet vet ta paguajnë gjeometrin që të dali dh eta mas rrugën.

Kryesuesi i Kuvendit: Jo , jo shiqoni jo në rrugën e Zhtisë port ë Ballancës. Unë kam qenë aty kur është bërë matja e rrugës po ashtu ka qenë edhe vet Kryetari, po ashtu ka pasur edhe disa njerës tjetër po ashtu aty ka qenë edhe investitori që do ti kryej punët , kur kemi qenë në tereren, qytetarët duan që rruga të jet e zgjeruar ashtu sic është në skicë kurse ai don ta bëjë rrugën 3 m. gjerësi dhe nga gjysëm metre nga të dy anët e rrugës të ket trotuar dhe e tëra. Qytetarët vet kanë thënë, që ata do ta marrin gjeometrin uën isha prezent aty. Thanë se do ti përmbushin të gjitha ja edhe zotëri Stojkovic ka qenë prezent aty, ata vet kanë pranuar dhe se nuk kishte asnjë problem por ata për shkak të sigurisë së tyre që të mos u hyj rruga në pronën e tyre dhe e gjitha kjo është për këtë.

Delegati Naser Shabani: Mua më kanë thënë ndryshe.

Kryesuesi i Kuvendit: Jo, unë kamë qenë aty dhe bash kam biseduar me tad he ai tregoi pastaj dolën vëllezërit dhe thanë që për shkak të sigurisë të tyre do ta sjellin gjeometrin.

Delegati Naser Shabani: Unë desha të jem i sigurt, ta dij të vërtetën.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është e vërteta , ja edhe zotëri Stojkovic ishte aty. Nëse dëshiron tani do të shkojm tek ai pasi që edhe unë kam qenë ty dhe jam dëshmitar që t'ia dëshmoj që ajo nuk është ashtu sic të kanë thënë ty por kështu ka qenë dhe kur e flet të vërtetën nuk mundesh dikend që ta gënjesh, ai vet ka thënë që do ta sjell gjeometrin. Urdhëroni zotëri Kelmend.

Kelmend Rexhepi: Desha tap yes Shqiprimin sa përafërsisht është shuma e kyqjes në rrjetin e ujës-jellësit?

Shqiprim Rexhepi: Nuk ka shuëm aty janë diku rreth 20 deri 30 metra.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky nuk është investim i madh, këtë do ta kryejmë në ndonjë mënyrë tjetër, është e rëndësishme që fëmijët në shkollë nuk guxojnë të mbesin pa ujë të pijshëm. Këtë nuk e kemi ditur, kjo mund të përfundohet edhe në këtë vit e jo të presim vitin e ardhshëm. A ka edhe ndokush për të thënë

dicka? Pasi që askush nuk dëshiron të marrë fjalën i falemderoj të gjithë, faleminderit që morët pjesë në seancën e kuvendit komunal të sotëm. Po e mbyll seancën e gjashtë të rregullt të kuvendit komunal Klllokot-Vërbovc

Datë: 28,06,2019

Kryesuesi i Kuvendit komunal

Klllokot



/ Zarko Dejanovic /

